



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 1472 Prot.

Tiranë, më 21.02 2026

VENDIM QARKULLES

Nr. 113 dt. 21.02 2026

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.99 DATË 01.07.2026 “PËR MIRATIMIN E
HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT “BACHELOR” NË
“DIETOLOGJI”, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI
I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT DHE UNIVERSITETIT “MAGNA GRAECIA”
TË KATANXAROS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Senatit nr.99 datë 01.07.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Vendimit nr.99 datë 01.07.2026 “Për miratimin e hapjes së Programit të Përbashkët të studimit “Bachelor” në “Dietologji”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit “Magna Graecia” të Katanxaros në Itali”, në pikën 2 të tij sipas këtij përcaktimi: “Programi i Përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe italiane
2. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASAP

